# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-463721**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Trump kërcënon Iranin me “zhdukje”, Pezeshkian nga OKB-ja: Nuk dorëzohemi! |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1393680.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 19:03:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 23 shtator 2026, 18:17:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 23 shtator 2026, 18:16:00 UTC → 23 shtator 2026, 18:18:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f8a861307030f35882651fe48db676fb9955ed3f1364b14fa047595672dd6311` |
| TEKSTI | `33a5aa798746474514ce7db316b436956cd94a82a303502bf0cd5c0b0cc7e180` |
| PAMJA | `7555cbaee99af081cf51f0596b81319af16a670200ba70ebb5296d6c5ef7b158` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `127d96a6f3cba0642de2834e3a1f9d044ec6a5a7ffb2f3446068f57825aa551e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/127d96a6f3cba0642de2834e3a1f9d044ec6a5a7ffb2f3446068f57825aa551e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Trump kërcënon Iranin me “zhdukje”, Pezeshkian nga OKB-ja: Nuk dorëzohemi!

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 23.09.2026, 20:17

Share Share



Presidenti amerikan Donald Trump ka kërcënuar se mund ta “zhdukë” Iranin nëse nuk arrihet një marrëveshje për t’i dhënë fund luftës, ndërsa presidenti iranian Masoud Pezeshkian i është përgjigjur nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së se Teherani nuk do të dorëzohet përballë presionit amerikan.

Gjatë fjalimit të tij në OKB më 22 shtator, Trump tha se përballet me një “vendim të madh” mes arritjes së një marrëveshjeje me Iranin dhe vazhdimit të presionit ushtarak. Ai paralajmëroi se, në mungesë të një marrëveshjeje, SHBA mund ta “zhdukte” Republikën Islamike të Iranit. Në të njëjtën kohë, Trump la të kuptohej se një marrëveshje mund të arrihet dhe se diplomacia mbetet në tryezë.

Një ditë më pas, Pezeshkian iu përgjigj nga foltorja e OKB-së, duke i cilësuar deklaratat e Trump si shenjë të një “mentaliteti imponues”. Presidenti iranian deklaroi se populli iranian nuk do t’i nënshtrohet presionit dhe se kërcënimet vetëm sa e forcojnë vendosmërinë e Teheranit.

Megjithatë, Pezeshkian tha se Irani mbetet i gatshëm për dialog, negociata dhe diplomaci me SHBA-në, por jo në kushtet e presionit apo kërcënimeve.

Deklaratat e dy presidentëve vijnë në një moment kur SHBA dhe Irani po përpiqen të mbajnë të hapur kanalet diplomatike. Sipas Reuters, zyrtarë amerikanë dhe iranianë zhvilluan gjithashtu bisedime indirekte në Nju Jork, përmes ndërmjetësve, në përpjekje për të gjetur një rrugëdalje nga konflikti.

Pavarësisht toneve të ashpra publike, të dyja palët kanë lënë të hapur mundësinë e një marrëveshjeje diplomatike.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

## TË NGJASHME




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.